



Cikli i Parë (Bachelor)

Sqarim në lidhje me pagesën e tarifës së shkollimit për vitin akademik 2018-2019

1. Studentët e Ciklit të Parë (Bachelor) **do të paguajnë 50% të tarifës**, sipas VKM-së Nr. 778 datë 26.12.2018, **pra 12,500 lekë**.
2. Studentët e Ciklit të Parë (Bachelor) të cilët i përkasin kategorive përjashtimore sipas VKM-së Nr. 269 datë 29.03.2017, **do të paguajnë 0 lekë**.
3. Studentët e Ciklit të Parë (Bachelor) të cilët janë me notë mesatare vjetore 9 deri në 10, sipas VKM-së Nr. 779 datë 26.12.2018 **do të paguajnë 0 lekë**.

Sqarim në lidhje me përfitimin e bursës për vitin akademik 2018-2019

1. Studentët e Ciklit të Parë (Bachelor) të cilët kanë përfituar **bursë të plotë**, sipas VKM-së Nr. 903 datë 21.12.2016, do të përfitojnë **8,900 lekë** për periudhën **16 tetor – dhjetor 2018**. Për periudhën **Janar 2019 e deri në përfundim të vitit akademik 2018-2019**, sipas VKM-së Nr. 784 datë 26.12.2018, **do të përfitojnë 10,000 lekë**. Ndërsa ata që kanë përfituar **gjysëm burse** do të përfitojnë **4,450 lekë** për periudhën **16 tetor – dhjetor 2018** dhe **5,000 lekë** për periudhën **Janar 2019 e deri në përfundim të vitit akademik 2018-2019**.
2. Studentët e Ciklit të Parë (Bachelor) **viti i parë**, të cilët janë me notë mesatare vjetore 9 deri në 10, e përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore (sipas listës së përcjell nga MASR), sipas VKM-së Nr. 903 datë 21.12.2016 do të përfitojnë bursë të plotë **8,900 lekë** për periudhën **16 tetor – dhjetor 2018**. Për periudhën **Janar 2019 e deri në përfundim të vitit akademik 2018-2019** sipas VKM-së Nr. 784 datë 26.12.2018, **do të përfitojnë 10,000 lekë**.
3. Studentët e Ciklit të Parë (Bachelor) **viti i dytë dhe i tretë**, të cilët janë me notë mesatare vjetore 9 deri në 10, sipas VKM-së Nr. 784 datë 26.12.2018, për periudhën **Janar 2019 e deri në përfundim të vitit akademik 2018-2019 do të përfitojnë bursë të plotë 10,000 lekë**.